LIGJ
Nr. 10 022, datë 24.11.2008

PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHTESË NË LIGJIN NR.8537, DATË 18.10.1999 "PËR BARRËT SIGURUESE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8537, datë 18.10.1999 "Për barrët siguruese", të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

Neni 1

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 25
Regjistri i barrëve siguruese

Regjistri i barrëve siguruese krijohet dhe ofron shërbimin e regjistrimit të barrëve siguruese, të pretendimeve dhe të të drejtave, që lindin nga ky ligj ose nga çdo ligj tjetër, i cili kërkon ose lejon regjistrimin në këtë regjistër.

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës është përgjegjëse për veprimtarinë e regjistrit të barrëve siguruese.

Në rastet kur ky shërbim i delegohet një personi juridik privat, në formën e koncesionit, sipas ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", ofruesi i shërbimit i propozon Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës emërimin e kryeregjistruesit të regjistrit të barrëve siguruese dhe të një ose disa zëvendësve të tij.

Në të gjitha rastet, regjistri i barrëve siguruese është pronë publike.".

Neni 2

Në fund të nenit 27 "Përgjegjësia e Këshillit të Ministrave" shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Në rastet kur ky shërbim ofrohet nga një subjekt juridik privat, ofruesi i shërbimit është përgjegjës për humbjen e shkaktuar, si rezultat i gabimeve ose mosfunksionimit të sistemit të regjistrimit. Kufijtë e përgjegjësisë dhe mënyra se si do të garantohet mbulimi i humbjeve përcaktohen në kontratën e lidhur ndërmjet palëve.

Shteti nuk ka detyrim të mbulojë efektet (humbjet), në rast të deklarimit të barrëve false.".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5973, datë 12.12.2008 të Presidentit të Republikës së

Shqipërisë, Bamir Topi